VENDIM
Nr.923, datë 10.11.2010

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.48, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MASËN DHE KRITERET E PËRFITIMIT NGA PROGRAMI I NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË NË VËSHTIRËSI", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 "Për nxitjen e punësimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.48, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas shkronjës "e" shtohet shkronja "ë", me këtë përmbajtje:

"ë) emigrantët e kthyer me probleme ekonomike.".

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha